

maklena f. nika  
**nitroglicerinė**  
poezi

---

BOTIMET TOENA



maklena f. nika

**nitroglicerinë**

poezi

**BOTIMET TOENA**

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Eris Rusi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Mirjana Madhi

ISBN: 9789928376565

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

*gjaku tim*

*... shkruaj në vetën e parë për të qenë i sigurt se jam gjallë...*


“Fizika e trishtimit”, Georgi Gospodinov




*nitroglicerinë* 11  
*kurë poetike* 12  
*oksimoronet vazhdojnë* 13  
*dopaminë ndjesore* 14  
*serotoninë dashurie* 15  
*folie à deux* 16  
*gjak hëne* 17  
*erotike epiderme* 19  
*autohipnozë* 20  
*infirmierë irracionalë* 21  
*betadinë e bakërt* 22  
*hemorragji* 23  
*ultrakorten* 24  
*mbetje spitalore* 25  
*prerje tërthore* 26  
*haloterapi* 27  
*helioterapi* 28  
*hidroterapi* 29  
*aritmi* 30  
*abort* 31  
*proteza* 32  
*antitrupa* 33  
*imunitet* 34  
*psikozë* 35  
*mrekullia surrealistike kardiake* 36  
*shkrim automat drenazhi limfatik* 37  
*dashuri e çmendur psikedelike* 38  
*e rastësishme objektive leukoplast* 39

*humor i zi cezarian* 41  
*në barelë* 42  
*kartela* 43  
*transplant* 44  
*operacion plastik* 45  
*balona gastrike* 46  
*shfarosje kimike* 47  
*plazmë e minuar* 49  
*tumor i shpërbërë* 50  
*jetë toksike* 51  
*zinxhir ADN-je* 52  
*yll autoimun* 54  
*kujtesa kromofage* 55  
*anamnezë* 56  
*suturë* 57  
*magji rakitike* 58  
*çaste sterile* 59  
*psikopatë të përzhitur* 60  
*autoklavë atmosferike* 61  
*trishtim i qelbëzuar* 62  
*lumturi lebrose* 63  
*diskinezi dëshirash* 64  
*ankth apo plogështi* 66  
*gjarpri helmues* 67  
*ditë e re diabetike* 69  
*tretësirë tabush* 70  
*venus venoze* 72  
*praktikante paraprake* 73

<i>medikament marrëzie</i>	75
<i>bipolaritet i brishtë</i>	76
<i>oksigjen operativ</i>	77
<i>rimbursim rrëqethës</i>	78
<i>patologjia e harresës</i>	80
<i>interpretim diagnoze</i>	81
<i>sindroma e të dielës</i>	82
<i>pashërueshmëria</i>	83
<i>aepnea</i>	85
<i>reminishencë reanimatore</i>	88
<i>varrime të vobekta</i>	91
<i>dimension deliriumi</i>	93
<i>aksident atomesh</i>	95
<i>heshtje hematomash</i>	97
<i>mjeku i lashtësisë</i>	98
<i>zhvatje zhardhokësh</i>	100
<i>kontradiktë kaotike</i>	102
<i>syri i tretë</i>	104
<i>një sëmundje e re</i>	106
<i>në konvaleshencë</i>	108
<i>x.embrioni monomer</i>	111
<i>një lindje e bukur</i>	113
<i>të pagojë të lindur</i>	114
<i>jerm jashtëtokësor</i>	117
<i>neurone të ngordhura</i>	120
<i>placebo</i>	121
<i>entropi neto</i>	122
<i>nitroglicerinë e përpunuar</i>	124
<i>nitroglicerina ime</i>	125









## *nitroglicerinë*

në triadën time psikike  
kam gjetur  
shumë nitroglicerinë  
shumë morfinë të simfonisë suaj

kam gjakun tuaj që shkruaj këto poezi  
kam venat tuaja që më vështrojnë në çdo vegulli vetmie  
kam nitratin tuaj të argjendtë në lotët e mi të lumturisë  
kam glicerinën tuaj të parfumuar për zbutjen e dhimbjeve të mia

muzika juaj e pambuktë më nanuris e më vë në gjumë  
netëve anemike dhe atrofike

kur muzika ime i ngjason një marshi funebër  
kam shumë nitroglicerinë nga ju  
për të normalizuar tensionin tim të brendshëm *in situ*

shoh dritën të shpërthejë mbi vernikun e diellit  
kur gëlltis tabletat e nitroglicerinës (*që m'i keni dhënë me kaq dashuri ndër vite*)  
pas sulmeve në zemër

ju dua, f. d.



## *kurë poetike*

*trupi ynë ka aftësinë të vetëshërohet  
forcat natyrore brenda nesh janë shëruesit e vërtetë të sëmundjes*  
Hipokrati

kam shumë fetuse poetike të ngjizura me hënoren dhe dielloren  
si anelgjezikë anginash acetilkoline të çoksigjenuara nga mungesa muskujsh  
në endometra të trashë mpiksjes gjaku gjakpërlyer në hedonizëm

i kam si kurë poetike serotonine në raste akute asfiksish frymëmarrjeje  
apo në djegie a shtrëngim muskuli të zemrës nga duhanpirja

fetuset e mia poetikë më oksigjenojnë qenien  
si neuroza transference  
më hapin venat e vetmuara  
si nitrate nanuritëse

e kam gjetur kurën time poetike  
si serum fjalësh të flakura në harresë  
që i rikthej sërish te vetja  
në vargje vaskulare  
të kirurgjisë sime

jam në depresion poetik të parrezikshëm



## *oksimoronet vazhdojnë*

*të kundërtat shërohen me të kundërta*  
Hipokrati

është patologji e përhershme  
*oksimoronopatologjia* ime  
nuk kërkoj medikamente mrekullibërëse  
as laksativë lehtësues të inerteve të identiteteve të mia  
jam pacienti dhe kuruesi i oksimoroneve të mia

e shtroj veten në spitalin neurologjik të vetvetes sime  
e kuroj me poetiken e protezave të mia të vetimprovizuara  
dal shëtitje në kopshtet e trëndafilta të imagjinatës sime  
gjej serumet spazmatike për damarët e mi diellorë  
më dhemb gjilpëra që i ngul vetvetes së ngurtësuar  
gjaku më djeg kur dëshira kundërshton logjikën e laturisur nga urthet e urgjencës urtikarie  
janë oksimorone në brendësinë time qelizore  
i kam pranuar si anomali  
fizike apo patologjike, tashmë

janë oksimoronet e mia  
janë ortopeditë e mia për të qëndruar drejt  
në jetë



## *dopaminë ndjesore*

*(ah, ti nuk e di që je me fat, krejt rastësisht)*

ndjenjat e kalcifikuara nga artriti i kohës  
u ngërthyen në inkubatorin tënd  
në ngërthesën e imazhit tënd të paqartë  
si mjegullirë acidike  
dhe unë si fëmijë i lindur para kohe  
duhet të qëndroja në këtë inkubator të rritesha  
të formësohesha  
si foshnjë e sapodalë nga mitra e nënës sime  
të fitoja ngjyrën e trëndafiltë të lëkurës së kaltëruar  
të forcoja gjymtyrët e mi të pathemeltë  
që gravitet nuk kishin  
të falsifikoja identitetet e mia të flashkëta ndër vite të venitura  
të farkëtoja fatalizma femërorë të saturuar  
në sadizëm sekrecionesh  
më duhej të vendosesha në pikën zero  
kur (ri)lind  
dhe të rritesha  
dhe të jetoja si të gjithë psikopatët e tjerë  
  
në dopaminë ndjesore



## *serotoninë dashurie*

kur dashuria e përskuqi borën  
dhe e kuqja me të bardhën bënë dashuri  
mbi kocka kalciumi flokësh dëbore  
dhe u dhanë frymë qelizave të kujtesës  
lëngata muzikore u shkrua mbi pentagrame të brishtë shkurti

të papeshë ndjeva gjithë trupin  
nga humbja  
avullimi  
kondensimi  
i lëngjeve të bardha mbi të kuqen e puthjeve

bashkë me borën binin butësisht  
mbi bashkime bulimie  
mbi serotoninë dashurie



## *folie à deux*

kitara të kadifenjta  
violonçela të vjollcë  
prodhojmë psikoza perandorish të çakorduara në *limbo*  
vazhdojmë të jemi kitara kontradiktore  
nga çakordimet e çakërdisura të telave kimerikë  
kitara dhe violonçela të kërrusur e të vetmuar  
të veshur me metal ku përthyeret tingulli *arcana*  
në kurthe kurrizdala të verdhëzës vetmitare

në *Belle Époque* prodhojmë muzikë të qelibartë membranash qelizore  
që kërkohet në kuptohen nga konstelacionet yjore të emulsioneve epshore

vazhdojmë të jemi kitara të çakorduara  
në pamjaftueshmëri kardiake

skulptura kinetike  
drejt muzikës së universit estetik

*folie à deux*





## *gjak hëne*

edhe hëna ka gjak  
të përmujorshme hënore  
sa bëhet e plotë  
si femër koketë  
dhe të imponohet me tërësinë femërore

hëna është femër  
derdh mbi tokë lëngun magjik të orgazmës me vetveten  
që neutralizon të gjithë (pseudo)lëngjet mashkullore

kur bëhet e plotë  
i ngrin në kohë gjithë speciet mashkullore  
që nuk e kuptojnë shndritjen e saj nga aq larg dhe afër  
shndritjen e gjakut që rrjedh si një masë viskoze dhe mbush krateret e saj  
dhe mbulon spermën e tyre të përshënur

kur bëhet e plotë  
përmyt penisët e tyre me butësi  
me prekje hënore  
sa i kthen në krimba të vegjël që zvarriten në gjakun e saj

pamje makabre hënore  
*(nuk e kuptojnë të gjithë, madje edhe qeshin me ironi me këtë vërshim viskoz vezësh)*  
që të mpiks edhe gjakun tënd të shëndetshëm *(sipas analizave të fundit laboratorike)*



të pyesin: çfarë po ndodh, me gjak hënë në buzë  
si të përgjigjesh e përgjakur përballë gjakosjes së gishtave të tyre  
që enden si të lodhur në vaginën tënde

*(verën e pimë në gota të kristalta mbretërore)*

verën e shohim të derdhet nga gotat e rrumbullakëta si hënë e plotë janari  
i mbushim plot  
me hinka hapësinore  
e ndiejmë të na rrëshqasë në gishtërinj dhe në gjuhë të mpirë nga loja  
e pimë në gojë të përgjakur nga të përmujorshmet hënore

gjak hëne  
gjak femëror

megjithatë, shumë i bardhë më dukesh  
në të kuqen time

*(formula e gjakut tim ka shumë eritrocite)*



## *erotike epiderme*

*(vetëm të dëshiroj në erotizmin tim)*

erotiken time të butë e preke  
shumë egërsisht  
me pendën e kuqe të blerë në Muzeun e Rembrandit  
*apodyopsis* i epidermës së fjalëve  
si kapitullim pa kushte  
përpara erotikes shkatërrimtare  
të neurokimive tona të frymëmarrjeve halotropike

*(Holandë, kutërbon erë seksi, ndërsa unë vështroj vështrimpyetëse rrudhat e tua të erotizmit të munguar, që thua se nuk të bëjnë përshtypje...)*



## *autohipnozë*

vjen papritur  
të kap në befasi  
sëmundja e inteligjencës

të ngërthen muskujt e sipërm  
dhe të heq fjalën  
veprimin  
vertebrat t'i paralizon  
me parazitët e saj që janë shumëfishuar në qenien tënde  
çfarë po ndodh? - pyesin atomet e tua që përpëliten si peshq të pabindur në bregun  
e lebroseve

por ti u mësove tashmë  
me këtë autohipnozë në vetmi  
një lloj psikoterapie e ëmbël për toksinat trunore

për të nesërmen e ndritshme  
duhet të zgjohesh  
nga narkoza e netëve

